



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:194837
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05637077

KPPP.nr.14714/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “Elektro GG” ShPK, me numër unik identifikues 810873134 me seli në Prishtinë, Rr.”Vushtrisë” Nr.5, kundër debitorit “Selmans Netëork” ShPK, me numër unik identifikues 810815061, me seli në Prishtinë me adresë në Rr”Jakov Xoxa”, Kompleksi Blini Co, p.n., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër urdhrin përbarimor P.Nr. 535/23 të datës 24.08.2023 të Përbaruesit Privat Rrezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Selmans Netëork” ShPK, me numër unik identifikues 810815061, me seli në Prishtinë me adresë në Rr”Jakov Xoxa”, Kompleksi Blini Co, p.n., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 535/23 të datës 24.08.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat Rrezarta Metaj, dhe i njëjti Urdhër MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.Nr. 535/23 të datës 24.08.2023 duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të

besueshëm–faturave Nr.23-SHV01-002-2802, të dt.19.05.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2321, të dt.26.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2273, të dt.24.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1565, të dt.20.03.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1135, të dt.02.03.2023, me të cilin ka urdhëruar që në emër të përmbushjes së obligimeve, t'i paguajë kreditorit shumën e prej 4,068.55Euro, me kamatën referente si pjesë e kamatës ligjore, duke e llogaritur nga data kur kërkesa është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore.

Kundër urdhrit të Përmbartuesit Privat, ka ushtruar prapësim debitori, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marrë vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv dhe si rrjedhojë nuk ka tipare të pambarueshme.

Tutje ka shtuar se faturat në bazë të së cilave është lëshuar urdhri përmbartimor nuk janë pranuar nga debitori dhe se i njëjti dyshon së faturat e bashkëngjitura propozimit për përmbartim janë origjinale andaj edhe propozimi për përmbartim nuk përmban elementet përkitazi me dispozitat ligjore, më saktësisht me nenin 38 dhe 43 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

Ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbartimor si dhe të përfundohet në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

Kreditori në përgjigje në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor ka theksuar se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri përmbartimor i janë dërguar në mënyrë të rregullt debitorit ku i njëjti i ka nënshkruar dhe se asnjëherë nuk i ka kundërshtuar faturat dhe përmbajtjen e tyre, andaj pretendimet e debitorit janë të pabaza dhe kanë për pasojë vetëm prolongimin e procedurës përmbartimore.

Ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ta lë në fuqi urdhrin përmbartimor.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërkaq me paragrafin 3 të po të

njëjtë nën, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturat Nr.23-SHV01-002-2802, të dt.19.05.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2321, të dt.26.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2273, të dt.24.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1565, të dt.20.03.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1135, të dt.02.03.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtjesore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat Nr.23-SHV01-002-2802, të dt.19.05.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2321, të dt.26.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-2273, të dt.24.04.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1565, të dt.20.03.2023, Faturës Nr.SHV01-002-1135, të dt.02.03.2023, i plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi në këto fatura janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njëjta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit se faturat në bazë të së cilave është lëshuar urdhri përmbartimor nuk janë pranuar nga ana e debitorit, mirëpo kjo gjë lehtësisht vërtetohet se këto fatura i janë dorëzuar në mënyrë të rregullt debitorit dhe se i ka pranuar të njëjtat duke vënë nënshkrimin e tij në ditën e pranimit.

Bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1471/23, me datë 29.01.2024

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.